



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Kryesia e Kuvendit

P-006

Prishtinë, më 14.01 2015, në orën 12:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 14 JANAR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, dhe Glauk Konjufca, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Uran Ismaili dhe Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Emrush Haxhiu, Xheladin Hoxha, Sali Rexhep dhe Musli Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryetari, në vazhdim procedoi me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetari i njoftoi nënkryetarët e Kuvendit me shkresën e dërguar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit për vendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për ndërmarrjen “Trepça”, datë 9 janar 2015.

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri, në cilësinë e Komisionit Funksional, e ka shqyrtuar shkresën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe ka rekomanduar që të iniciohet procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike.

Për të proceduar me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, i cili duhet të hyjë në fuqi para datës 2 shkurt 2015, ne duhet të procedojmë me këtë projektligj duke iu shmangur procedurave të rregullta, të parapara me Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin e projektligjeve.

Procedimi dhe miratimi i këtij projektligji nuk ka të bëjë me çështje e pozitës, apo të opozitës, por ka të bëjë me mijëra punëtorë të Kombinatit “Trepça”, me familjet e tyre, me çështje ekonomike dhe politike të vendit.

Pastaj, kryetari e hapi diskutimin.

Lidhur me procedimin e projektligjit për ndërmarrjet publike dhe zgjidhjen e statusit të Kombinatit “Trepça” diskutuan: Glauk Konjufca, Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, nënkryetarë të Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia njëzëri:

V E N D O S I

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike të procedohet, duke bërë shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike të bëhet të hënën, më 19 janar 2015, në orën 10:00.
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike të bëhet të hënën, më 19 janar 2015, në orën 16:00, pasi ta shqyrtojnë komisionet parlamentare.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 13:00 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale